

The logo for BellTours, featuring the word "BellTours" in a white, elegant script font with a decorative flourish underneath.

BellTours

A scenic view of a traditional Japanese temple with multiple tiers and a pagoda, set against a backdrop of a city and a snow-capped mountain (Mt. Fuji) under a sunset sky. The foreground is filled with blooming pink cherry blossoms.

**KOREJA E JUGUT &
JAPONIA**

A view of a traditional Korean temple with a large, ornate roof, surrounded by blooming pink cherry blossoms under a blue sky with white clouds.

19 – 30 MARS 2026

Dita 1: **Enjte, 19 mars 2026** **Tiranë**

20:30 Nisja nga Tirana drejt Stambollit me Turkish Airlines

Dita 2: **Premte, 20 mars 2026** **Seul**

00:20 Mbërritja në Stamboll

02:15 Nisja nga Stambolli drejt Seulit me Turkish Airlines

18:20 Mbërritja në Seul

Transferta në hotel dhe Check-in. Lotte City Hotel Myeongdong 4*

Kohë e lirë për të eksploruar qytetin.

Udhëtimi juaj i mrekullueshëm nis në Seul, një metropol gjigant i shtrirë në luginën e lumit Han. Ky është një qytet i kontrasteve, ku pallatet antike, rrokaqiejt e lartë dhe marketet plot gjallëri bashkëjetojnë në harmoni të plotë.

Nëse arrini herët, eksploroni këtë metropol modern aziatik me ritmin tuaj dhe zbuloni se si traditat e lashta ndërthuren pa sforcim me modernitetin, në një prej qyteteve më të mëdha të Azisë.

Dita 3: **Shtunë, 21 mars 2026** **Seul**



Tour i Seulit.

Në mëngjes, guida do t'ju marrë nga hoteli dhe do të nisni turin e Seulit, duke vizituar atraksione dhe përvoja mahnitëse. Do të eksploroni pallatin mbretëror madhështor, fshatin tradicional Hanok dhe do të zhyteni në jetën dhe kulturën dinamike vendase. Gjithashtu, do të keni mundësinë të provoni ushqime të

lehta (snacks) tipike koreane.

Ndalesa juaj e parë është **Shtëpia Blu Presidenciale (Cheongwadae)**, një simbol i pushtetit politik të Koresë së Jugut. Shijoni pamjen e çatisë karakteristike blu dhe arkitekturën moderne nga jashtë.

Më pas, do vijoni drejt **Pallatit Gyeongbokgung**, pallati më i madh dhe më i mirëmbajtur në Kore, i cili shërbeu si pallati kryesor i Dinastisë Joseon. I ndërtuar në vitin 1395 nga Mbreti Taejo Lee Seong-gye, ky pallat dëshmoi ngritjen dhe rënien e dinastisë. Planimetria e tij është e detajuar me përpikmëri dhe stili i tij arkitekturor është unik, duke përfaqësuar kulmin e artit arkitekturor korean. Është simboli më madhështor i historisë dhe kulturës koreane. I ndodhur në zemër të Seulit, ai njihet si "Pallati i Lumturisë së Madhe".

Pas eksplorimit të pallatit madhështor, do të vijoni me vizitën e shtëpive tradicionale koreane në **fshatin Bukchon Hanok**. Fshati Bukchon Hanok është një nga zonat më simpatike dhe historike të Seulit, i vendosur mes dy pallateve të mëdha, Gyeongbokgung dhe Changdeokgung. Ky fshat është i mirënjohur për shtëpitë e tij tradicionale koreane të mirëmbajtura, të njohura si “hanok”. Fillimisht një zonë banimi për fisnikërinë dhe zyrtarët e lartë të Dinastisë Joseon, Fshati Hanok në Bukchon karakterizohet nga numri i tij i madh i banesave hanok.




Më pas, larg nga zhurma dhe rrëmuja e qytetit do të vizitoni **Tempullin Jogyesa**. I themeluar në vitin 1395. Ai shërben si selia qendrore e Urdhrit Jogye të Budizmit Korean dhe një nga tempujt më të rëndësishëm në Seul. Në këtë tempull të qetë dhe paqësor, ju do të përjetoni një kuptim më të thellë të budizmit dhe kulturës koreane. Ndryshe nga shumica e tempujve që ndodhen në male, Jogyesa ndodhet në qendër të qytetit, duke krijuar një kontrast unik mes qetësisë shpirtërore dhe jetës moderne.

Më pas do të vijoni te **Rruga e Artit dhe Antikuariateve në Insadong**, e cila është e mirënjohur për skenën e saj kulturore plot gjallëri dhe punimet tradicionale artizanale koreane. Atje do të shihni një gamë të gjerë të artit tradicional korean, duke përfshirë pikturat, kaligrafinë, qeramikën dhe skulpturat. Gjithashtu, mund të ndiqni performanca tradicionale koreane, si vallëzime dhe muzikë tradicionale që shpesh organizohen në rrugë.

Pas kësaj, do të zhyteni në atmosferën e gjallë të **Tregut të Ushqimit Gwangjang (Gwangjang Market)**, një parajsë kulinare ku mund të shijoni një shumëllojshmëri të ushqimeve të shijshme të rrugës koreane. Ku mund të provoni pjatat popullore si bindaetteok (pancakes me fasule mung), tteokbokki (pulaçe orizi pikante), kimbap (rula orizi me alga deti) dhe mayak gimbap (rula orizi në version mini), si dhe Kimchi Jeon (pancakes me kimchi). Gwangjang Market është një nga tregjet tradicionale më të vjetra dhe më të mëdha në Korenë e Jugut, i hapur që në vitin 1905. Edhe pse shitet gjithçka, nga tekstilet te veshjet tradicionale (Hanbok), ai është bërë i famshëm në mbarë botën si parajsja e ushqimit të rrugës.

Pas përfundimit të turit, kthimi në hotel, Lotte City Hotel Myeongdong 4*, në Seul.

Këtë ditë, do të niseni për një udhëtim intrigues drejt kufirit më të ruajtur në botë: **DMZ-së së Koresë (Zona e Çmilitarizuar)**. Aventurë në zemër të DMZ-së, aty ku jehonat e historisë



botë.

dhe dëshira e zjarrtë për bashkim rrethojnë çdo cep. Zona e Çmilitarizuar është një nga vendet më unike dhe më të tensionuara në botë. Ajo shërben si një zonë tampon mes Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut, e krijuar në vitin 1953 pas nënshkrimit të armëpushimit që ndaloj luftimet e Luftës së Koresë. Kufiri është një rrip toke rreth 250 km i gjatë dhe 4 km i gjerë që ndan gadishullin në dy pjesë. Edhe pse quhet "e çmilitarizuar", në fakt është kufiri më i fortifikuar dhe më i ruajtur ushtarakisht në


Pas mëngjesit, do të vijoni me eksplorimin e tokës së shenjtë të **Parkut Imjingak** dhe ndjeni peshën e së kaluarës ndërsa kaloni **Urën e Lirisë, Freedom Bridge ose Dokgaedari**, një nga pikat më prekëse dhe simbolike në Parkun Imjingak, rreth 50 km në veri të Seulit. Ajo shërben si një kujtesë e gjallë e ndarjes së Koresë dhe dëshirës për liri.

Parku Imjingak është një vend me rëndësi të jashtëzakonshme emocionale dhe historike, i vendosur në brigjet e lumit Imjin, shumë pranë vijës së demarkacionit që ndan dy Koretë.

Ndryshe nga pjesët e tjera të DMZ-së ku kërkohen kontrole ushtarake, Imjingak është një park i hapur për publikun dhe shërben si pika e fundit ku civilët mund të shkojnë lirisht përpara se të hyjnë në zonën e kufizuar.



Tuneli i Infiltrimit i Tretë. I njohur thjesht si "Tuneli i Tretë", është një nga pikat më drithëruese dhe më të vizituara të zonës DMZ, si dëshmi rrëqethëse e një toke të ndarë. Ai dëshmon përpjekjet sekrete të Koresë së Veriut për të pushtuar Jugun dekada pas luftës.



U zbulua në tetor të vitit 1978, falë informacionit të dhënë nga një dezertor (ish-punëtor) nga Korea e Veriut.

Do të vizitoni **Teatrin e DMZ-së dhe Sallën e Ekspozitave**, ku tregimet e trimërisë dhe konfliktit pikturojnë një portret të pashlyeshëm.

Nga **Observatori Dora**, hidhni një vështrim drejt Koresë së Veriut enigmatike, e mbuluar me mister. Dora Observatory është pika më veriore e Koresë së Jugut në malin

Dorasan, nga ku mund të shihni drejtpërdrejt brenda territorit të Koresë së Veriut. Është vendi ku "kuriotizeti takohet me realitetin", pasi është pika më e afërt ku një civil mund të vëzhgojë jetën në anën tjetër të kufirit.

Më pas, në **Stacionin Dorasan**, shijoni simbolikën e shpresës, kufirin e fundit përpara bashkimit.

Kthimi në Seul, ku do të vizitoni **Muzeun e Memorialit të Luftës në Yongsan**, që nderon heronjtë, të cilët skalitën trimërinë e tyre gjatë viteve.



Pas kthimit në Seul, do të eksploron **Hongdae, një lagje moderne e Seulit**, e mirënjohur për atmosferën e saj rinore, jetën e natës plot gjallëri dhe përvojat unike të blerjeve. Mund të shëtitni nëpër butikë, të eksploron dyqanet e kozmetikës ose të provoni disa nga ushqimet e shijshme të rrugës.

Akomodimi në Seul, në Lotte City Hotel Myeongdong 4*.

Dita 5:

Hënë, 23 mars 2026

Tokio

13:05 Fluturimi nga Seuli për në Tokio

15:30 Mbërritja në Tokio

Me mbërritjen tuaj në aeroportin e Tokios, shoferi dhe guida do t'ju presin në dalje dhe më pas do t'ju shoqërojnë për në hotel.

Transferta në hotel dhe Check-in. Tokyo Dome Hotel 4*.

Pushim në hotel kohë e lirë për të eksploruar Tokion.

Tokio, kryeqyteti i Japonisë, është një nga qendrat më të mëdha ekonomike të Japonisë dhe Azisë. Është një qendër e kulturës dhe artit japonez, me muze të shumtë, galeri arti, teatro dhe vende kulturore, duke shërbyer si një platformë jetike për aktivitetet artistike dhe shkëmbimet kulturore.

Dita 6:

Martë, 24 mars 2026

Tokio

Tour i Tokios.



Do ta nisni ditën duke vizituar **Tempullin Meiji Jingu (Tempulli Meiji)**, një tempull Shinto kushtuar Perandorit Meiji (1852-1912) dhe Perandoreshës Shoken (1849-1914), të cilët luajtën një rol vendimtar në modernizimin e Japonisë, duke e transformuar nga një shtet feudal në një fuqi moderne gjatë fundit të shekullit të 19-të, ndërsa shkëlqyen në shkrimin e Waka (poezi tradicionale japoneze me 31 rrokje sipas modelit 5-7-5-7-7). Tempulli Meiji

është gjithashtu një vend shumë i pëlqyer për dasmat tradicionale, ku do të keni mundësinë të shihni një procesion dasme japoneze dhe të përjetoni magjinë e kulturës tradicionale japoneze.

Këshilla për vizitën në Tempullin Meiji Jingu:

- Vishni veshje modeste: Respektoni natyrën e shenjtë të tempullit duke u veshur në mënyrë të përshtatshme.
- Bëni kujdes me nivelin e zhurmës: Ruani një atmosferë të qetë dhe respektuese.
- **Kopshti i brendshëm** (Opsional; me pagesë vetjake; dikur pronë perandorake), dhe **Muzeu Meiji Jingu** (Opsional; me pagesë vetjake; objekte të përdorura nga çifti perandorak).

Më pas, do të vizitoni **Kryqëzimin Shibuya**, një nga udhëkryqet më të ngarkuara në botë, ku kalojnë afërsisht 3,000 njerëz në minutë. Si një nga vendet ikonike të Tokjos, Shibuya tërheq turistë dhe fotografë nga mbarë bota, të cilët vijnë për të vëzhguar dhe kapur esencën e tij. Filma të shumtë, emisione televizive, reklama dhe klipe muzikore janë xhiruar në këtë vendndodhje, si për shembull "The Fast and the Furious: Tokyo Drift."



Pasdite do të vizitoni **Tempullin Senso-ji (Tempulli Asakusa Kannon)**, një vend që duhet



vizituar patjetër nga kushdo që udhëton në Tokjo. Gjatë kohës që jeni atje, sigurohuni të shkreptni një foto të Tokyo Skytree, kulla më e lartë e Japonisë, e cila duket qartë në distancë. Tempulli Senso-ji është një nga tempujt budistë më të vjetër dhe më të famshëm në Tokjo, i vendosur në lagjen Asakusa të Taito-s. Ky tempull i kushtohet Kannon Bosatsu-së (Avalokiteshvara), Bodhisattva-s së mëshirës. Sipas

legendës, në vitin 628 pas Krishtit, dy peshkatarë nxorën një statujë të Kannon-it nga Lumi Sumida dhe vendosën të ndërtonin një tempull për ta lartësuar atë. I përfunduar në vitin 645 pas Krishtit, Senso-ji që prej asaj kohe është bërë një simbol shpirtëror i Tokjos, dhe zemra e "Tokios së vjetër".

Më pas do të eksploroni **Tregun e Peshkut Tsukiji (tani Pazari Toyosu)**, një nga destinacionet më legjendare të Tokios për dashamirësit e ushqimit. Pazari i Peshkut Tsukiji ishte dikur pazari më i madh i peshkut në botë, i famshëm për ankandet e tij të tonit. Megjithatë, në vitin 2018, ai u zhvendos në një objekt të ri e më të madh të quajtur Pazari Toyosu. Ju mund të shijoni ende fruta deti të freskëta (sashimi, sushi, ose tasa me oriz dhe fruta deti), të blini pajisje kuzhine dhe të mësoni për një shumëllojshmëri produktesh deti, duke përfshirë karakteristikat, metodat e gatimit dhe vlerat ushqyese të llojeve të ndryshme.



Më pas, kthimi në Tokio dhe akomodimi në hotel, Tokyo Dome Hotel 4*.



Tokio - Mali Fuji - Tokio

Kjo ditë do të jetë një udhëtim vajtje-ardhje (300 km) që zgjat gjithë ditën, për të admiruar pamjet që të lënë pa frymë të Malit Fuji nga Stacioni i 5-të i Malit Fuji dhe Liqeni Kawaguchi.

Mali Fuji është mali më i lartë në Japoni. Ai është një vullkan i famshëm me një formë konike përsosmërisht simetrike. Vizita në Malin Fuji është thelbësore për çdo udhëtar në Japoni.

Si një sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, Mali Fuji (3,776 m) qëndron si një simbol ikonik i Japonisë, një pikë referimi kulturore dhe shpirtërore (i njohur si mal i shenjtë në Shintoizëm) dhe një mrekulli natyrore.

Stacioni i 5-të i Malit Fuji. Fuji Subaru Line 5th Station është pika më e njohur dhe më e aksesueshme për turistët që duan të përjetojnë madhësinë e simbolit të Japonisë pa pasur nevojë të ngjiten deri në majë. I ndodhur në lartësinë 2,305 metra mbi nivelin e detit, ky stacion shërben si "kufiri" mes botës së zakonshme dhe botës shpirtërore të malit të shenjtë.

Do të filloni shëtitjen tuaj drejt **Liqenit Kawaguchi** përgjatë bregut. Liqeni Kawaguchi është i mirënjohur për ujërat e tij të kthjellët, që shpesh pasqyrojnë Malin Fuji madhështor (nëse moti e lejon), duke krijuar një skenë perfekte si kartolinë dhe duke e bërë atë një destinacion mjaft të pëlqyer si për turistët vendas, ashtu edhe për ata ndërkombëtarë.





Për adhuruesit e artit, ndalesa tjetër është **Muzeu i Artit Kubota Itchiku**, i cili ndodhet pranë Liqenit Kawaguchi. Itchiku Kubota Art Museum është një nga muzetë më magjepsës dhe estetishtë unikë në Japoni, i vendosur pranë brigjeve të Liqenit Kawaguchi. Ai nuk është thjesht një hapësirë ekspozite, por një kryevepër arkitekturore që bashkon natyrën, tekstin dhe filozofinë. Muzeu i kushtohet artistit Itchiku Kubota

(1917–2003), i cili ringjalli teknikën e humbur të dekorimit të kimonove nga periudha Muromachi (shekulli i 14-të deri në 16-të).

Pas eksplorimit të muzeut, do të përjetoni një eksperiencë piktoreske: **një lundrim paqësor në Liqenin Kawaguchi**. Ky udhëtim i qetë me anije ofron pamje të bukura të Malit Fuji nga uji, duke shijuar peizazhin nga një perspektivë tjetër.

Më pas, kthimi në Tokio dhe akomodimi në hotel, Tokyo Dome Hotel 4*.

Udhëtimi me **trenin e shpejtë (Tokyo Shinkansen)** nga Tokio në Kioto (rreth 2.5 orë). Një shofer do t'ju presë në hyrje të hotelit në orarin e caktuar dhe do t'ju transportojë për në Stacionin e Tokjos.

Ky udhëtim i shpejtë dhe komod ofron mundësinë për të shijuar peizazhet ndryshuese të Japonisë urbane dhe rurale.

Me mbërritjen në Kioto, guida lokale dhe shoferi do t'ju presin në zonën e caktuar për t'ju shoqëruar për vizitat turistike të ditës në Kioto.

Pasdite, grupi do të vizitojë një nga pamjet më ikonike të Kiotos, **Tempullin Kinkaku-ji** - një sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe i njohur botërisht si "Pavijoni i Artë". Ky tempull budist Zen është i famshëm për pamjen e jashtme mahnitëse, të artë. Pamja vizuale e tempullit vjen nga dy katet e tij të sipërme, të cilat janë plotësisht të mbuluara me fletë ari. Pasqyrimi i strukturës së artë që vezullon në pellgun përballë tij, e bën atë të përsosur për foto.



Më pas, do të vizitoni **Kështjellën Nijo (Nijō-jō)**, një tjetër sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, simbol i historisë feudale të Japonisë. E ndërtuar në vitin 1603 si rezidenca në Kioto e Tokugawa Iyasu-s, shogunit të parë të periudhës Edo, hapësirat e saj të gjera dhe arkitektura e zbukuruar nxjerrin në pah fuqinë dhe pasurinë e klaneve dominuese samurai gjatë periudhës Edo (1603-1867). Ndryshe nga kështjellat e tjera japoneze që janë ndërtuar

kryesisht për mbrojtje ushtarake, Nijo u ndërtua si rezidencë për të treguar pasurinë dhe autoritetin.

Pas turit, akomodimi në hotel, Kyoto Tokyu Hotel 5*, në Kioto.

Tour i Kiotos

Pas mëngjesit, do të eksploron Kioton për një ditë të plotë. Dita do të nisë herët, për të shmangur turmat e njerëzve, në një nga pikat e tij më ikonike – **Faltoren Fushimi Inari Taisha**.

Faltorja Fushimi Inari Taisha është e famshme për mijëra portat e saj torii në ngjyrë vermilion (e kuqe e ndezur), të njohura si Senbon Torii ("mijëra porta torii"). Shtresa të panumërta portash vermilion veshin faqen e harlisur dhe të pyllëzuar të kodrës, duke formuar një korridor që duket i pafund. Portat në ngjyrë portokalli të ndezur dhe të zezë krijojnë një kontrast të bukur me gjelbërimin



rrethues, duke krijuar një shteg mahnitës vizualisht dhe pothuajse jashtëtokësor. Faltorja Fushimi Inari Taisha është ndoshta vendi më ikonik i të gjithë Japonisë dhe faltorja kryesore kushtuar Inarit, hyjnisë Shinto të orizit, begatisë dhe suksesit në biznes.

Këshilla: Ngjitja deri në majën e malit dhe kthimi zgjat dy deri në tre orë, por shumë njerëz shkojnë vetëm deri te kryqëzimi Yotsutsuji, pasi përtej kësaj pike numri i portave torii rrallohet. Do t'ju duhen rreth 30 deri në 40 minuta për të mbërritur në Yotsutsuji.



Vizita tjetër do të jetë në **Tempullin Kiyomizu-dera**, një sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. I vendosur në faqen e kodrës së Kiotos Lindore, ky tempull është i mirënjohur për platformën e tij prej druri që zgjatet mbi kodër, duke ofruar pamje mahnitëse të qytetit dhe natyrës rrethuese. Salla kryesore e tempullit, e ndërtuar tërësisht pa përdorimin e gozhdëve, është një mrekulli arkitekturore. Kiyomizu-dera është gjithashtu i famshëm për ujërat e tij të

shenjtë, të cilët besohet se kanë fuqi për plotësimin e dëshirave, gjë që tërheq vizitorë të panumërt që vijnë për të pirë nga rrjedha e tij.

Shënim: Peizazhi në Tempullin Kiyomizudera është i bukur në mënyrë të veçantë në çdo stinë, duke ofruar një sharm unik gjatë gjithë vitit. Në pranverë, malet stolisen me lulet magjepsëse të qershisë; në verë, ato harlisen nga gjelbërimi i gjallë; në vjeshtë, dekorohen me gjethe me ngjyra të shndritshme; dhe në dimër, mbushen me pemë magjepsëse (shpesh të mbuluara nga dëbora).

Më pas, do të ecni lart nëpër **Ninenzaka dhe Sannenzaka**, dy nga rrugicat më të bukura dhe më mirë të ruajtura në të gjithë Japoninë. Këto rrugë simpatike të pjerrëta janë të rreshtuara me dyqane tradicionale dhe shtëpi çaji karakteristike, duke ofruar një pamje nostalgjike të së kaluarës së Kiotos. Ndërsa shëtisni nëpër këto zona, mund të blini punime artizanale unike, të provoni ushqime të lehta lokale (snacks) dhe mbase të ndaloni në një kafene për t'u çlodhur dhe për të shijuar atmosferën e Kiotos së vjetër.



Më pas do të vijoni drejt **Faltore Yasaka**, faltorja mbrojtëse e distriktit të argëtimit Gion, lagjes së Geishave, e cila daton mbi 1350 vjet më parë. Faltorja Yasaka pëlqehet



veçanërisht nga ata që kërkojnë bukuri dhe pasuri. Duke vizituar këtë faltore të rëndësishme Shinto në Kioto, edhe ju mund të gjeni veten duke fituar pak fat të mirë. Faltorja është më e famshme për festivalin Gion Matsuri në korrik, gjatë të cilit mund të shikoni procesionin ku hyjnitë e Yasaka-s parakalojnë nëpër rrugët e qytetit.

Ngjitur me faltoren ndodhet **Gion, distrikti i famshëm i geishave** në Kioto. Në Kioto, geishat quhen Geiko. Maiko janë nxënëset (vajzat e reja) që trajnohen për t'u bërë Geiko. Ato dallohen nga kimonot më shumëgjyreshe dhe dekorimet më të ngarkuara në flokë. Këtu, ju mund të shihni për një çast Geishat (Geiko) me kimonot e tyre dhe grimin tradicional.



Ndërsa shëtisni nëpër rrugët me kalldrëm të Gion-it, shikoni dhe shtëpitë machiya (shtëpi tradicionale prej druri), ochaya (shtëpi çaji) dhe ryotei ekskluzive (restorante tradicionale japoneze) të ruajtura bukur.

Pas turit, kthimi dhe akomodimi në hotel, Kyoto Tokyu Hotel 5*.

Dita 10:

Shtunë, 28 mars 2026

Kioto, Nara, Osaka

Kioto - Nara - Osaka

Këtë mëngjes, do të niseni nga Kioto për t'u drejtuar **Narës**, një udhëtim që zgjat rreth 1.5 orë. Përpara se të ishte Kioto, ishte Nara – kryeqyteti i parë i përhershëm i Japonisë dhe



një nga destinacionet më shpërblyese të vendit. Nara krenohet me 8 site të Trashëgimisë Kulturore Botërore, gjë që e bën atë qytetin e dytë më të pasur kulturalisht në Japoni pas Kiotos.

Vizitoni **Tempullin Todai-ji**, një nga tempujt më të rëndësishëm historikisht në Japoni dhe një sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Ai është i njohur për strehimin e statujës më të madhe në botë prej bronzi të Budës Vairocana, e cila qëndron pak mbi 16 metra e lartë

dhe përbëhet nga 437 ton bronz dhe 130 kg ar. Ky tempull nuk është thjesht një vend lutjeje, por një simbol i pushtetit perandorak dhe i përhapjes së Budizmit në shekullin e 8-të.

Më pas do të shëtitni drejt **Parkut të Narës**, një nga parqet më unike në botë dhe zemra historike e qytetit të Narës. I krijuar në vitin 1880, ky park është i famshëm për qindra drerët që lëvizin lirshëm, të cilët konsiderohen lajmëtarë të perëndive në traditën Shinto. Blini disa shika senbei (krejera për drerët) për t'i ushqyer ata ndërsa shëtisni nëpër park.



Drejtohuni drejt **Kasuga Taisha (Shenjtërorja e Madhe Kasuga)**, shenjtërorja Shinto më e famshme e Narës dhe një tjetër sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Ajo është e mirënjohur për fenerët e saj, të cilët janë dhuruar nga besimtarët.

Pas turit, do të udhëtoni drejt **Osakës** (zakonisht zgjat rreth 45 minuta deri në një orë). Osaka, qyteti i tretë më i madh i Japonisë dhe një qendër kryesore ekonomike, është i mirënjohur për historinë e tij të pasur, kuzhinën e shumëllojshme, kulturën e veçantë dhe fuqinë e qëndrueshme ekonomike.

Së fundi, shijoni blerjet në **Rrugën Tregtare Shinsaibashi-suji**, "Meka" e blerjeve në Osaka dhe një nga rrugët tregtare më të vjetra dhe më të rëndësishme të Japonisë. Me një histori që daton mbi 380 vjet, kjo rrugë është zemra e gjallë e distriktit Minami.

Më pas, drejtohuni drejt **distriktit të Dotonbori-t**. Ai është veçanërisht vezullues gjatë sezonit të festave, me dekorime të varura përgjatë urave. Plot me restorante, klube dhe bar-karaoke, është zona kryesore e qytetit për argëtim.

Pas turit, kthimi dhe akomodimi në hotel Osaka Excel Hotel Tokyu 4*, në Osaka.

Dita 11: Diel, 29 mars 2026 Aeroport

Checkout
Nisja drejt Aeroportit
22:10 Nisja nga Osaka drejt Stambollit me Turkish Airline

Dita 12: Hënë, 30 mars 2026

05:00 Mbërritja të Stamboll
08:00 Nisja nga Stambolli drejt Tiranës me Turkish Airline
08:45 Mbërritja në Tiranë

<FUNDI I SHËRBIMEVE >

PËRFSHIHEN NË ÇMIM

- Fluturimet Tiranë – Seul (me bagazh të përfshirë 1 valixhe 20 kg dhe 1 valixhe dore 8 kg);
- Fluturimet Osaka – Tiranë (me bagazh të përfshirë 1 valixhe 20 kg dhe 1 valixhe dore 8 kg);
- Fluturimi Kore e Jugut – Japoni;
- Treni i shpejtë Tokio – Kyoto;
- Transferrat nga dhe për në aeroport;
- Transporti dhe transfertat në secilin qytet apo zonë, sipas itinerarit. **(Shënim: Nuk ka guidë turistike për marrjen dhe përcjelljen në aeroport);**
- Akomodimi në hotel 4* / 5* me mëngjes **(Shënim: Checkin pas orës 15:00 dhe checkout para orës 12:00);**
- Vizitat sipas itinerarit;
- Guidë në gjuhën angleze **(Shënim: Shërbimi i guidës është për maksimumi 8 orë. Guida dhe shoferi nuk do t'ju shoqërojnë nga një qytet në tjetrin);**
- Transporti i bagazheve ndërmjet aeroporteve, stacionit të trenit dhe hoteleve;
- Tarifa e vizës;
- Sigurimi i shëndetit në udhëtim.

NUK PËRFSHIHEN NË ÇMIM

- Vizitat / shëtitjet që nuk janë përfshirë në itinerar;
- Drekat dhe darkat;
- Bakshishet për guidat dhe shoferët. **(Shënim: Rekomandohet 10-15 USD për udhëtar në ditë si bakshish për guidën dhe 8-12 USD për udhëtar në ditë si bakshish për shoferin. Megjithatë, mund të paguani më shumë ose më pak në varësi të shërbimeve të tyre);**
- Shpenzimet personale si: shërbimi në dhomë, tarifa e internetit, larja e rrobave, pije, faks, telefonata, aktivitete të tjera, etj.;
- Taksa e akomodimit në hotel. Këto taksa paguhen në vend;
- Gjithçka që nuk është përmendur më sipër.